

STRONG ALBANIAN
LOCAL STATISTICS

STATISTIKA TË FORTA
VENDORE SHQIPTARE



Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Swiss Agency for Development
and Cooperation SDC

INSTAT
Republika e Shqipërisë
Institut i Statistikave

- SALSTAT -

Newsletter

STRONG ALBANIAN LOCAL STATISTICS

Tetor 2020 - Mars 2021

Projekti "Strong Albanian Local Statistics" (Për Statistika të Forta Vendore Shqiptare, SALSTAT) është pjesë e projektit ombrellë "Bashki të Forta", financuar nga Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC) për një periudhë katërvjeçare. Projekti "Bashki të Forta" punon për zhvillimin dhe decentralizimin e qeverisjes vendore në Shqipëri.

Tri palët kyçe të interesit në këtë projekt janë INSTAT-i, bashkitë, si dhe disa ministri të linjës dhe agjenci qeveritare, veçanërisht ato që kanë për detyrë mbledhjen e të dhënave statistikore zyrtare dhe/ose përgjegjëse për të dhënat/regjistrat administrativë. INSTAT-i është partneri kyç i projektit SALSTAT. Ministritë e linjës dhe bashkitë janë partnere thelbësore pasi ato do të jenë, si përdorueset, ashtu edhe prodhueset e të dhënave për statistikat vendore dhe rajonale.

- Pavarësisht situatës aktuale të vështirë të shkaktuar nga pandemia Covid-19, projekti SALSTAT ka ecur në mënyrë të kënaqshme, ndërsa veprimtaritë e rëndësishme arritën të përmbylleshin me sukses gjatë 6 muajve të fundit.

Përmbajtja:

- Shpërndarja e Vjetarit Statistikor Rajonal 2020
- Tregues shtesë në nivel rajonal dhe vendor - Bashkitë si ofrues të të dhënave
- Trajnime për stafin e INSTAT-it rreth metodave statistikore për anketat model
- Trajnimet për bashkitë

Shpërndarja e Vjetarit Statistikor Rajonal 2020

SALSTAT-i e konsideron Vjetarin Rajonal si një botim të rëndësishëm për shpërndarjen e treguesve kyç statistikorë në nivel rajonal dhe vendor:

Vjetari Statistikor Rajonal 2020, paraqet një vështrim gjithëpërfshirës të treguesve statistikorë më të rëndësishëm të vendit për periudhën 2018-2019.

Nëpërmjet këtij botimi, INSTAT-i synon të paraqesë në një vëllim të vetëm një përmbledhje të plotë të statistikave sociale dhe ekonomike për të gjitha prefekturat e vendit, për një periudhë të caktuar. Vjetari Statistikor Rajonal mbetet një nga botimet më të rëndësishme të INSTAT-it, pasi iu vjen në ndihmë të gjithë përdoruesve; vendimmarrësve vendorë dhe qendrorë, administratorëve, komunitetit të biznesit, studiuesve, etj.

Vjetari Statistikor Rajonal ndahet në 19 kapituj, ku përfshihet një kapitull përmbledhës për secilën prefekturë dhe 18 kapituj tematikë, socialë dhe ekonomikë.

Risia e këtij botimi është kapitulli "Mjedisi". Dy kapituj përmbajnë tregues shtesë në nivel bashkiak. Kapitulli "Struktura administrative dhe njësitë territoriale të Shqipërisë" përmban një seksion krejtësisht të ri, të titulluar "Shqipëria në rajon (vendet jashtë BE-së)".

Gjithashtu, Vjetari ka një strukturë të re dhe kapitujt përmbajnë harta tematike që të pasqyrojnë krahasimet ndërmjet rajoneve dhe bashkive.

Kjo punë është realizuar në bashkëpunim të ngushtë me Zyrën Federale Zvicerane të Statistikave (ZFS).


Versioni në gjuhën angleze dhe shqipe i Vjetarit Statistikor Rajonal 2020 gjendet në faqen zyrtare të internetit të INSTAT-it: www.instat.gov.al

Versioni në anglisht:

<http://www.instat.gov.al/en/publications/books/2020/regional-statistical-yearbook-2020/>

Versioni në shqip:

<http://www.instat.gov.al/al/publikime/librat/2021/vjetari-rajonal-statistikor-2020/>



Tregues shtesë në nivel rajonal dhe vendor - Bashkitë si ofrues të të dhënave

SALSTAT-i së bashku me INSTAT-in vijnë të ofrojnë të dhëna statistikore në nivel rajonal dhe vendor. Në këtë kontekst, INSTAT-i po planifikon të zgjerojë dhe përmirësojë më tej treguesit kyç, si dhe ofrimin e treguesve të rinj në terma afatshkurtër, afatmesëm dhe afatgjatë në nivel rajonal dhe vendor.

Për këtë arsye, INSTAT-i u ka dërguar bashkive një pyetësor online për t'u plotësuar me të dhëna të mundshme statistikore që disponojnë bashkitë. Synimi i anketimit ka qenë mbledhja e informacionit rreth të dhënave statistikore që disponohen në nivel bashkie.

Për hapin e radhës, INSTAT-i do të analizojë rezultatet dhe do të vendosë se cilat të dhëna mund të mbledhen dhe shpërndahen për të ofruar tregues statistikorë shtesë në fusha të tjera statistikore.

INSTAT-i planifikon të lidhë një Memorandum Mirëkuptimi ndërmjet partnerëve me qëllim përmirësimin e bashkëpunimit me bashkitë. Rezultatet e anketimit do të integrohen në shtojcën e Memorandumit të Mirëkuptimit.

Trajnime për stafin e INSTAT-it për metodat statistikore për anketat model

Në dhjetor 2020 u zhvilluan disa seminare online, me stafin e INSTAT-it dhe një ekspert ndërkombëtar, lidhur me metodat statistikore për anketat model. Trajnimi u përqendrua në Statistikat për të Ardhurat dhe Nivelin e Jetesës së Bashkimit Evropian (EU-SILC). EU-SILC synon të mbledhë të dhëna mikro, krahasimore shumëdimensionale, nga burime të ndryshme dhe të shtrira në kohë për të ardhurat, varfërinë, përjashtimin social dhe kushtet e jetesës. Shqipëria e ka përshtatur metodologjinë e EU-SILC-ut për kushtet e saj kombëtare.

Megjithatë, deri më sot, treguesit e varfërisë publikoheshin në nivel kombëtar si dhe në nivel të veçantë të fushave të interesit të përcaktuara sipas grupmoshës, gjinisë dhe statusit të punësimit. Meqenëse ka dallime të ndjeshme midis prefekturave në Shqipëri, nevoja për tregues rajonalë të varfërisë, në veçanti për matjen e nivelit të rrezikut të të qenit të varfër në nivel rajonal, përbën thelbin e kursit metodologjik të të dhënave të EU-SILC-ut.

Qëllimi është shpërndarja e treguesve të varfërisë në nivel prefekturash në Vjetarin e ardhshëm Rajonal Statistikor 2021.

Trajnimet për bashkitë

Për shkak të pandemisë, trajnimet e planifikuara për bashkitë kërkonin planifikim dhe përgatitje të hollësishme. Në mars 2021, SALSTAT-i dhe INSTAT-i arritën të organizonin një trajnim të përparuar rreth përdorimit të Excel-it për prezantimin e informacionit statistikor nga stafi i bashkive. Trajnimi u zhvillua në ambientet e INSTAT-it në gjashtë ditë të ndryshme përgjatë muajit mars 2021.

Për shkak të situatës së pandemisë, trajnimet u zhvilluan në grupe të vogla duke respektuar të gjitha masat e Qeverisë kundër COVID-19.

Baza e trajnimit të Excel-it ishte ofrimi i aftësive të përparuara stafit të bashkive për të analizuar dhe shpërndarë informacionin statistikor nëpërmjet programit Microsoft Excel.

Në trajnimin e avancuar të Excel-it morën pjesë punonjës të 40 bashkive.

Gjithsej, u aftësuan 53 punonjës, 36 prej të cilëve, ose 68% e totalit të trajnuar, ishin gra.

SALSTAT-i planifikon të vijojë me trajnime të tjera lidhur me statistikat zyrtare për bashkitë nëpërmjet zbatimit të projektit. Grupi tjetër është planifikuar për T2/T3 2021.



FALEMINDERIT NGA EKIPI SALSTAT

Menaxher Projekti:

Martin Teichgräber, Zyra Federale Zvicerane e Statistikave

Koordinatorë:

Eralda Pushaj, Koordinatore me Njësitë e Qeverisjes Qendrore

Alketa Doçi, Koordinatore për Regjistrat dhe të Dhënat Administrative

Edlira Çeliku, Koordinatore Administrative dhe Financiare

Instituti i Statistikave, Tiranë

Rr. Vllazën Huta, Ndërtesa 35, Hyrja 1, Tiranë,

Kodi Postar 1017 E-mail: info@instat.gov.al

Telefoni: +355 (4) 2233356 / 2233358